



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 142, datë 30.07.2018

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR. 89, DATË 27.06.2016
“PËR KRITERET DHE KËRKESAT PËR MIRATIMIN E SHOQËRISË AUDITUESE
TË SHOQËRIVE ADMINISTRUESE TË SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE
KOLEKTIVE DHE SHOQËRIVE ADMINISTRUESE TË FONDEVE TË PENSIONIT
VULLNETAR”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike dhe Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve e Fondeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr. 89, datë 27.06.2016 “Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI

Në Rregulloren nr. 89, datë 27.06.2016 “Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në nenin 2, në fund, shtohet shprehja “i ndryshuar”
2. Në nenin 3:
 - 2.1 Pika 1, pas shprehjes “Ligjin nr. 10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, shtohet shprehja “i ndryshuar”;
 - 2.2 Pika 1, shkronja “b”, shprehja “ekspert kontabël i regjistruar”, zëvendësohet me shprehjen “auditues ligjor”;
 - 2.3 Pika 1, shkronja “d”, pas shprehjes “Ligjit nr. 10 091, date 05.03.2009 “Për auditimin ligjor”, shtohet shprehja “i ndryshuar”;
 - 2.4 Pika 2, shprehja “ekspert kontabël i regjistruar” zëvendësohet me shprehjen “auditues ligjor”.
3. Në nenin 4, pika 1:
 - 3.1 Shkronja “d”, shprehja “Instituti i Ekspertëve Kontabël të Regjistruar (IEKR)”, zëvendësohet me shprehjen “Organizata profesionale e audituesve ligjorë/Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar”;
 - 3.2 Pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “d/1”, me këtë përmbajtje:

“d/1) Vërtetim nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), që vërteton se “ortaku kryesor i auditimit” ose të punësuarit e shoqërisë audituese me titull profesional “auditues ligjor” kanë jo më pak se 3 (tre) vite përvojë në fushën e auditimit të pasqyrave financiare të subjekteve financiare që zbatojnë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar (SNRF-ve)”;
 - 3.3 Shkronja “e”, fjala “Deklaratë”, zëvendësohet me shprehjen “Vërtetim i Organizatës profesionale të audituesve ligjorë/Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar;
 - 3.4 Në shkronjën “f”, pas shprehjes “në nenin 3, pika 1, shkronja “e” shtohet, shprehja “dhe pika 2, shkronja “b””.
4. Në nenin 5, pika 1, shprehja “jo me vonë se data 30 maj”, zëvendësohet me shprehjen “jo më vonë se data 31 korrik”.
5. Në nenin 6, pika 1, pas shprehjes “Ligjin nr. 10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, shtohet shprehja “i ndryshuar”.